

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil** si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtari Misin Frangu me sek.juridike Ardita Tasholli, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], Komuna Ferizaj, kundër të paditurve: [REDACTED] ish nga fsh. [REDACTED] Komuna Ferizaj, [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], Komuna Ferizaj, [REDACTED] ish nga fsh. [REDACTED] Komuna Ferizaj, tani të gjithë me adresë të panjohur, baza e kontestit vërtetim i pronësisë, vlera e kontestit 35.000 €, sipas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datën 13.06.2016, shpall këtë:

### AKTGJYKIM

**I.APROVOHET** padia dhe kërkesëpadia e paditesit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], Komuna Ferizaj”, dhe i njihet e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale: Parcela Kadastrale- njësia me nr.P-72217090-00495-0, me sip. Prej 285 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale – njësia me nr. [REDACTED] me sip. Prej 185 m2, në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrake – njësia me nr.P-72217090-00497-0, me sip.prej 1654 m2, në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale-njesia, me nr.P-72217090-00498-0, me sip.prej 475 m2, në vendin equajtur, “Te Qeshmja” ZK.Dardani Parcela Kadastrale- njësia me nr.P-72217090-00499-0, me sip.650 m2, në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale –njësia me nr.P-72217090-00484-0 me sip.625 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale- njësia me nr,P-72217090-00485-0 me sip.210 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale- njësia me nr.P-72217090-00486-0 me sip.500 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale-njesia me nr.P-72217090-00487-0 me sip.2888 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale-njesia me nr.P-72217090-00488-0 me sip.670 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale-njesia me nr.P-72217090-00490-0, me sip.635 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale-njesia me nr.P-72217090-00491-1, me sip.523 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale-njesia me nr.P-72217090-00492-0, me sip.1689 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale-njesia me nr.P-72217090-00493-0,me sip.250 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale –njësia me nr.P-72217090-00494-0, me sip.250 m2, në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani Zona Kadastrale Dardani, Parcela Kadastrle- njësia me nr.P-72217090-00489-0, me sip.645 m2 në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, Parcela Kadastrale – njësia me nr.P-72217090-00491-2, me sip.12 m2. në vendin e quajtur “Te Qeshmja” ZK.Dardani, në bazë të shitblerjes – mbajtjes.

**DETYROHEN** të paditurit [REDACTED] / 3. [REDACTED] të i'a njohin të drejtën e pronësisë paditësit [REDACTED] tani me adresë të panjohur, dhe të durojnë që ngastrat e lartpërmendur të regjistrohet në emër të tij.

**DETYROHET Drejtoria për Kadastër, Pronësi dhe Gjeodezi në Ferizaj**, që të bëjë ndryshimin në bazë të këtij aktgjykimi.

**II.** Shpenzimet e procedurës do ti heqë paditësi, taksat për aktgjykim në shumë prej 175 €, si dhe taksat për padi shumen prej 125 €.

## Arsyetim

Paditësi ka ushtruar padi me shkrim me dt.31.08.2015, pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj me bazën juridike vërtetimi i pronësisë në bazë të shitblerjes dhe mbajtjes.

Gjykata kishte kërkuar nga AKP-ja, që të na njoftoj lidhur me ndonjë kërkesë eventuale pranë këtij agjensionit të ndonjë pretenduesi të pronës se zhvillohet apo nuk zhvillohet ndonjë kontest për ngastrat e lartshënuara. Dhe nga ky agjension ishte informuar se për ngastrat e lartpërmendura nuk ishte paraqitur asnjë kërkesë as nga personat fizik por as nga ata juridik.

Në seancën përgatitore me dt.24.02.2016, paditësi [REDAKTUAR] kishte mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë, duke kërkuar nga gjykata që ti njihet e drejta e pronësisë të ngastrave kadastrale të shënuar si në padi, ngase këto ngastra i kemi blerë nga të paditurit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], që nga viti 1982-83, të cilat i kemi paguar menjëherë dhe për këto kemi dëftesat për të cilat i kemi paguar këto ngastra, dhe pas pagesës kemi hyre në posedim, pasi që kishim paguar çmimin e kontraktuar dhe që nga ajo kohë e kemi shfrytëzuar pa u penguar nga askush, të njëjtat edhe tani i shfrytëzojmë. Paditësi ka propozuar që paditësve t'ju caktoj përfaqësuesin e përkohshëm. Në këtë seancë gjykata me propozimin e paditësit, kishte vendosur që t'ju caktoj një përfaqësues të përkohshëm të paditurve, ku përfaqësues të përkohshëm ju kishte caktuar av. [REDAKTUAR], avokat nga Ferizaj. Kurse në seancën e radhës me dt. 31.03.2016, gjykata kishte vendosur të caktoj një ekspert të gjeodezisë që të dilet në teren dhe të bëhet identifikimi i ngastrave kadastrale kontestuese.

Përfaqësuesi i përkohshëm i te paditurve, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDAKTUAR], e kishte kundërshtuar kërkesë padinë e paditësit por jo edhe vendimin për daljen në vendin e ngjarjes në fsh. [REDAKTUAR], Komuna Ferizaj. Në vendin e ngjarjes me dt.14.04.2016, gjykata kishte konstatuar se paditësi [REDAKTUAR] ngastrat kontestuese i shfrytëzon dhe këto ngastra kishin qenë në shfrytëzim të paditësit, në ngastrat kadastrale paditësi kishte të ndërtuara tri shtëpi banimi, pastaj objekte afariste, garazhe - auto servisë për rregullimin e automjeteve, ndërsa pjesa tjetër e ngastrave kadastrale shfrytëzohet si tokë punuese.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve av. [REDAKTUAR] nuk e ka kundërshtuar identifikimin që kishte bërë eksperti gjeodet për ngastrat në fjalë, por e kishte kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit duke rezervuar të drejtën për deklarime në seancën kryesore,

Në këtë seance paditësi ka propozuar që në cilësinë e dëshmitarëve të dëgjohet [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR].

Dëshmitari [REDAKTUAR] ka deklaruar: se unë kam qenë prezent në shitblerjen e këtyre ngastrave kadastrale, dhe unë e di se çmimi kontraktues ju ka paguar në tërësi dhe që nga blerja e këtyre ngastrave kadastrale paditësi ka hyrë në posedim dhe i shfrytëzon pa u penguar nga askush deri më tani.

Dëshmitari [REDAKTUAR] ka deklaruar: unë nuk kam qenë prezentë kur është bërë shitblerja, por e di se këto ngastra kadastrale paditësi i ka blerë, i ka paguar në tërësi dhe që nga atëherë është në posedim të atyre ngastrave kadastrale dhe të njëjtat i shfrytëzon pa u penguar nga askush.

Dëshmitari [REDACTED] ka deklaruar : se ngastrat kadastrale i ka blerë babai ynë dhe paditësi, të njëjtat i kanë paguar në tërësi çmimin kontraktues dhe që nga momenti i shitblerjes e deri më tani të njëjtat i shfrytëzojnë pa u penguar nga askush, ka deklaruar se kam të ndërtuar shtëpinë P+1, dhe jetoj me familjen në këtë ngastër kadastrale, mirëpo me vëllaun tim – paditësin [REDACTED] jemi dakorduar që kjo polujshmëri të bartet në emër të paditësit [REDACTED].

Dëshmitari [REDACTED] ka deklaruar: se ngastrat kadastrale i ka blerë babai i ynë dhe paditësi të njëjtat i kanë paguar në tërësi çmimin kontraktues dhe që nga momenti i shitblerjes e deri me tani të njëjtat i shfrytëzojnë pa u penguar nga askush, ka deklaruar se kam të ndërtuar shtëpinë P+1, dhe jetoj me familjen në këtë ngastër kadastrale, mirëpo me vëllaun tim – paditësin [REDACTED] jemi dakorduar që kjo polujshmeri të bartet në emër të paditësit [REDACTED].

Ne seancën kryesore të datës 13.06.2016 paditësi kishte mbetur pranë thënieve nga seanca e kaluar duke i propozuar gjykatës që paditësit ti njihet e drejta e pronësisë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Leximi i Provave:

Lexohet certifikata e pronës në emër të [REDACTED] UL722 17090-00090 edt.07.06.2015, Lexohet certifikata e pronës në emër të [REDACTED], UL-72217090-00089 E DT.07.06.215, Lexohet certifikata e pronës në emër të [REDACTED] UL-72217090-00088 e dt. 107.06.2015, Lexohet përgjigja nga ana e AKP-së me nr. të referencës 00272/16 / VD e dt.11.03.2016, Lexohet memorandumi zyrtar nga drejtoria Rajonale e policisë së Ferizajt me nr. të referencës 04/1-05 F-287/16 e dt.04.03.2016, Lexohen dëftesat e dt.10.04.1986, e dt. 28.04.1986, e dt. 08.07.1983, e dt. 08.07.1983, e dt.08.04.1983, e dt.08.07.1984, e dt.29.12.1983, e dt.10.04.1986, Lexohet ekspertiza e ekspertit gjeodet [REDACTED] [REDACTED] e punuar me dt. 26.04.2016. Lexohet deklaratat e dëshmitarëve dhe të palëve.

Palët pa vërejtje në leximin e provave,

Fjala përfundimtare e palëve

Paditësi, [REDACTED] në fjalën përfundimtare deklaron: nga provat e shtjelluara në seancën e sotme dhe seancat e tjera është vërtetuar se ngastrat kadastrale kontestuese i kanë blerë dhe paguar në tërësi dhe që nga momenti i shitblerjes kanë hyrë në posedim të këtyre ngastrave dhe i posedoj pa u penguar nga askush deri më tani dhe nga këto theksime edhe baza ligjore u vërtetua edhe nga provat që gjenden në shkresat e lendes siq janë dëftesat e pagesave të viti 1983 -84 të cilat janë të hartuar me laps dore, kjo vërtetohet edhe nga deklaratat e dëshmitarëve të dhënë pranë kësaj gjykate, nga gjykata kërkohet që kërkesëpadinë time ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe që këto ngastrat kadastrale të bartet në emrin tim.

Përfaqësuesi i përkohshëm av. [REDACTED] në fjalën përfundimtare deklaron: mbas administrimit të provave posaçërisht bazuar në ekspertizën e ekspertit i cili ka bërë edhe identifikimin e parcelave po ashtu nga deklarata e dëshmitarëve, dhe dëftesat e pagesave është e kuart se në rastin konkret kemi të bëjmë me pasuri të palujshme e cila është blerë njeherit edhe është paguar gjate viteve 1983-86, bazuar në këtë fakt shihet se paditësi ka shfrytëzuar pronën e bërë të cilën për arsyes objektive nuk ka mundur ta bartë në emër të vet babai i tij e as ky si trashëgimtar, por të njëjtën e ka shfrytëzuar me mirëbesim andaj edhe pa mbështetje sipas ligjin mbi fitimin pronës gjegjësisht fitimi i pronës me mirëbesim. Po ashtu vëllëzërit e tij kanë deklaruar se pajtohen që kjo palujshmeri të figuron në emër të paditësit gjegjësisht vëllaut [REDACTED], edhe pse ende nuk kanë kryer procedurën e trashëgimisë për pasurinë të cilën ja ka lënë babai i tyre i ndjeri [REDACTED].

Gjykata duke u bazuar në neni 8 të LPK-së veçoj veç e veç. Certifikatën e pronës për ngastrat kontestuese në emër të pronarëve juridik [redacted] ish nga fsh. [redacted], K-Ferizaj, 2 [redacted] ish nga fsh. [redacted], K-Ferizaj, 3 [redacted] ish nga fsh. [redacted], K-Ferizaj, dëshmojnë se padia përputhet plotësisht në subjektin si pale kontestuese.

Ekspertizën e ekspertit të gjoedezisë tregon kompatibilitetin –përputhshmerine e kërkespadiisë në aspektin formal me gjendjen reale dhe faktike në teren si dhe gjendjen aktuale, mbi shfrytëzimin e kësaj ngastre katstrale dhe kontestuese deri më tani.

Deklaratat e dëshmitarëve të dhanuna në shqyrtimin kryesor e forcon kërkuesin e paditesit në njëren ane dhe besimin e Gjykatës për ndodhjen e punës juridike.

Kërkesa për verifikimin e adresës së të paditurit dhe përgjigja nga stacioni policor në Ferizaj e arsyeton vendimin e Gjykatës për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm për të paditurin sikurse që e arsyeton procedimin e kësaj lënde dhe vendosjen e përgjigja me nr.Ref.00294/16/vd e datës 24.03.2016, nga AKP-ja se vërtet për këtë ngastër kadastrale askush nga personat fizik dhe e as nga ata juridik nuk ka paraqitur kërkesë lidhur me këtë ngastër kontestuese.

Gjykata ka vërtetuar se në mes të paditësit [redacted] dhe të paditurit ka egzistuar raportin juridik i cili edhe pse i lidhur jo në formën e shkruar ka prodhuar efekt juridik, me faktin se kishte ndodhur trasankcioni në mes tyre si shitës dhe blerës. Këtë raport juridik paditësi e materializon duke hy në posedim të pa nderprerë dhe të pa penguar nga askush që nga viti 1982 ku dhe kishte paguar çmimin në tëresi.

Gjykata nga e drejta materiale konstaton se janë përmbushur kushtet nga neni 18 i LMD-së si dhe nga neni 36 i Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sndore, si dhe neni 28 par. 4 i Ligjit mbi Mardhenjet Pronësore Juridike i shpallë në G.Zyrtare të RSFJ” nr.6/80 dhe 37/90, të cilin raport edhe sot e legalizon dhe ligjitimon neni 40 par. 1 i Ligjit për të Drejtat Sndore nr.03/L-154 i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Andaj Gjykata duke u bazuar në gjithë këto prova dhe fakte të pakontestueshme duke qenë i pavarur në vendosje miratoi kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës do të bartë paditësi [redacted] neni 467. i LPK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**  
C.nr. 509/2015 Me.13.06.2016

Sek. Juridike:  
Ardita Tasholli



Gjyqtari  
Mitsin Frangu

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij Aktgjykimi mund të shpallë kërkesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

